

VENDIM
Nr. 96, datë 6.2.2013

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR MINISTRINË E
BRENDSHME, PËR PROGRAMIN E SHËRBIMIT TË GJENDJES CIVILE, PËR MBULIMIN E
SHPENZIMEVE TË PRINTIMIT TË LISTAVE TË ZGJEDHËSVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Brendshme, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, në programin “Shërbimi i Gjendjes Civile”, në artikullin 602 “Mallra e shërbime të tjera”, t’i shtohet fondi prej 14 311 630 (katërmëdhjetë milionë e treqind e njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë) lekësh, për mbulimin e shpenzimeve të printimit të listave të zgjedhësve, në funksion të plotësimit të nevojave të Shërbimit të Gjendjes Civile me letër dhe toner për printer.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministri i Financave dhe Ministri i Brendshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha